



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 485/1 Prot.

Tiranë, më 5 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 95 , Datë 5 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 113, datë 11.12.2014, të paraqitur nga subjekti ankues H.F, kundër Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, në të cilën pretendohet për shkak të “viktimizimit”¹. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë² nga H.F, pretendohet se është diskriminuar, sepse është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me kolegët e tjerë të fakultetit, dhe të gjitha këto veprime kanë ardhur pasi H.F me artikujt e botuar në media³ dhe me shkresat e drejtuara në organet e drejtësisë⁴ ka denoncuar shkeljet që ka vërejtur gjatë zhvillimit të veprimtarisë mësimore dhe administrative në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

Ankuesi deklaroi se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në procesin e dorëzimit të procesverbalit të notave të provimit të një lënde ndërkohë që vetë Dekani ka ende pa dorëzuar procesverbalin e notave të studentëve të doktoratës në lëndën “Metoda Kërkimore Sasiore” me doktorantët e kursit të regjistruar që në vitin akademik 2010-2011.

H.F informon se Dekani me shkresën nr. 385, datë 07.07.2014 ka kërkuar informacion se përse nuk janë dorëzuar në sekretarinë mësimore në kohën e duhur notat e provimeve për disa lëndë, katër nga këto lëndë janë zhvilluar nga pedagogë të tjerë, për të cilët nga ana e Dekanit nuk është marrë asnjë masë ndëshkimore.

¹ “...për shkak se ka denoncuar publikisht abuzimin me detyrën nga ana e drejtuesve të Universitetit”.

² Ankesë datë 11.12.2014, Shkresë për sqarime datë 23.12.2014, Shtesë Memo për ankesën datë 09.01.2015, Materiale plotësuese datë 21.01.2015, Shkresë informacion datë 27.03.2015.

³ Artikulli i botuar në gazetën Panorama, datë 09.09.2014

⁴ Procesverbal Komisarati Policisë Nr. 2, Tiranë, datë 26.05.2014, Ankesë drejtuar Rektorit të UT-s datë 30.05.2014, Kallëzim penal për shpërdorim detyre nr.3785, datë 13.06.2014 dhe Kallëzim për ndjekje penale nr.2784 datë 17.09.2014.

H.F shpjegon se vetëm për të është kryer verifikimi i procedurës së prezencës në punë dhe udhëtimeve jashtë shtetit (nëpërmjet sistemit TIMS) ndërkohë që dhe përgjegjës të departamenteve dhe pedagogë të tjerë të fakultetit, kanë udhëtuar jashtë shtetit dhe nuk janë kryer verifikime nga ana e drejtuesve të Universitetit.

Ankuesi shpjegon se nga ana e Dekanit i është konsideruar shkelje pse të gjitha provimet e studentëve të doktoratës i ka lënë për në fund të vitit, siç dhe parashikohet në planin mësimor dhe nuk i ka ndarë në semestra ndërkohë që plani mësimor nuk është i ndarë në semestra. H.F deklaron se Dekani nuk i ka kërkuar departamenteve të tjera që të mos zbatojnë planin e miratuar ndërkohë që për departamentin që drejton H.F e ka konsideruar shkelje zbatimin e planit ashtu siç ishte i miratuar.

Ankuesi deklaron se ka kërkuar të shtyhet për në Shtator zhvillimi i një pjese të lëndës në doktoraturë, ndërkohë që Departamenti i Psikologjisë, me përgjegjës A.T, ka harruar të zhvilloj një lëndë (Filozofi moderne-bashkëkohore) për një vit në nivelin master (Mësues i shkencave sociale), ndërsa në nivelin doktoral ka harruar dy lëndë pa zhvilluar të kursit teorik për vitin akademik 2010.

H.F shpjegon se Dekani i fakultetit ka konsideruar shkelje dhënien e një ore leksioni në periudhën Maj 2014 nga ana e H.F për të zëvendësuar pedagogen M.K pas propozimit të përgjegjës së Departamentit të Filozofisë, propozim që nuk ishte miratuar ende nga Dekani. Kjo shkelje e pretenduar nga Dekani për rastin e H.F dhe M.M nuk është konsideruar shkelje nga Dekani në rastin e zhvillimit të procesit mësimor për pedagogët e jashtëm të Fakultetit të Shkencave Sociale të cilët për të gjithë periudhën Shkurt-Mars-Prill 2014 kanë qenë të pa miratuar, por që kanë vazhduar që të japin mësim.

H.F deklaron se në diferencë me kolegët e tjerë i është konsideruar shkelje dhënia e dorëheqjes nga udhëheqja e diplomës së një studenti ndërkohë nuk ka asnjë rast tjetër që të jetë konsideruar shkelje pse pedagogu jep dorëheqje si drejtues i një teme diplome, qoftë me kërkesë të studentit apo të pedagogut.

Përmes kësaj ankese H.F kërkon nga Komisioneri, konstatimin e faktit të diskriminimit nga drejtuesi i fakultetit dhe marrjen e masave sipas ligjit.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,

gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga ankuesi, H.F, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

1. Me shkresën nr.1066/2 prot, datë 24.12.2014 të Komisionerit është njoftuar Universiteti i Tiranës, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe iu kërkua informacion mbi pretendimin e ngritur nga H.F.
2. Me shkresat me nr.19/1 prot., datë 13.01.2015, dhe me nr.105/2 prot., datë 10.02.2015 Universiteti i Tiranës ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e ankuesit dhe ka parashtruar argumentet e saj lidhur me shkarkimin nga detyra të H.F, ku theksohet se janë marrë dy masa disiplinore për shkak të shkeljeve të rënda dhe të përsëritura, prej tij.
Konkretisht:
 - Lidhur me Vendimin nr.103, datë 21.07.2014 me të cilin është shkarkuar nga detyra e Përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, sqarohet se: *“Ky shkarkim është kryer pasi H.F gjatë kryerjes së detyrës së tij ka shfaqur mangësi në kryerjen e saj; ka krijuar anomali në mbarëvajtjen e punëve të Departamentit; ka cenuar mbarëvajtjen e procesit mësimor lidhur me zbatimin e planeve dhe programeve mësimore; ka krijuar përplasje me autoritetet e tjera drejtuese, si ato paralele, ashtu dhe ato eprorë, duke cenuar funksionimin normal të aktivitetit të përditshëm; ka dëmtuar interesat e ligjshme të studentëve. Veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSh”, i ndryshuar, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UT-së”.*
 - Lidhur me Vendimin nr.163, datë 21.10.2014, UT-ja informon se ndaj H.F është marrë masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, pasi kishte kryer shkelje të rënda dhe të përsëritura të disiplinës në punë. Kështu nga verifikimet e bëra për plotësimin e listëprezencës në punë dhe informacionit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme⁵,

⁵ Referuar shkresës me nr.8560/1 prot., datë 14.10.2014.

vërtetohet se H.F ka qenë jashtë shtetit, kur sipas listëprezencave përkatëse rezultonte në punë.

- Nga ana tjetër, lidhur me këtë fakt, referuar shkresës së Dekanit të FSHS, për këto data nuk është marrë leje nga ankuesi, sikurse parashikohet në nenin 47 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në RSh”.
- H.F ka bërë dhe një shkelje tjetër akoma më të rëndë, për faktin se ai ka nënshkruar listëprezencat në punë dhe ka paraqitur në dokumentacionin zyrtar fakte të pavërteta për prezencën e tij në Institucion për datat: 20.02.2014, 21.02.2014, 21.03.2014, 26.09.2014, 27.09.2014, 17.10.2014, 18.10.2014, 30.10.2014, kur një gjë e tillë nuk ishte e vërtetë.
- Pra, UT-ja thekson faktin se në asnjë moment mendimet apo opinionet personale të H.F lidhur me punën e autoriteteve drejtuese të UT-së, nuk rezultojnë të kenë qenë shkak për të cilin ndaj tij janë dhënë dy masat disiplinore, sipërcituar. Arsyeja e vërtetë janë shkeljet e rënda dhe të përsëritura që ai ka bërë gjatë kryerjes së detyrës.
- Nga ana tjetër, ndaj H.F, UT-ja ka bërë një kallëzim penal për falsifikim të dokumentave zyrtare, çështje e cila aktualisht është nën hetim.

3. Me datë 27.05.2015⁶, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të UT-së.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me dy zv/Dekanët e FSHS, P.S dhe F.B, të cilët i qëndruan parashtrimeve të sjella me shkrim në shkresat me nr.19/1 prot., datë 13.01.2015 dhe me nr.105/2 prot., datë 10.02.2015.

Gjatë inspektimit u mor dokumentacioni mbështetës lidhur me argumentimin e UT-së se ankuesi nuk është diskriminuar nga ky Institucion.

4. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sipas nenit 33, pika 8, me datë 11.03.2015, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve.⁷

Seanca u zhvillua në mungesë të palës ankuese dhe vetëm me praninë e përfaqësueses së UT-së, A.B, me detyrë Juriste pranë këtij Institucioni⁸, e cila theksoi se i qëndron parashtrimeve të sjella me shkrim nga ana e UT-së.

Nga ana tjetër, A.B informoi se pretendimet e veta për diskriminim ankuesi i ka bërë objekt shqyrtimi në Gjykatë. Lidhur me këtë UT-ja do të sillte si provë një kopje të kërkesë-padisë të ankuesit, paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe një kopje të Vendimit të Kësaj Gjykate, për këtë çështje.

⁶ Në zbatim të Urdhërit nr.82, datë 21.05.2015, të Komisionerit.

⁷ Në zbatim të shkresës me nr.210 prot, datë 06.03.2015, të Komisionerit.

⁸ Referuar Autorizimit me nr.105/5 prot., datë 10.03.2015.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 194, datë 29.12.2016, me anë të të cilit në pikën 1 ka vendosur: "Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr.113, datë 11.12.2014, të H.F, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë".

H.F duke mos rënë dakord me Vendimin nr. 194, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila me Vendimin nr.2341 (80-2017-2372), datë 26.05.2017 ka vendosur: "Shfuqizimin e Vendimit nr.194, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe detyrimin e palës së paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të marrë vendim përfundimtar në lidhje me ankesën e palës paditëse H.F". Referuar shkresës nr.10798/1, datë 21.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendimi ka marrë formë të prerë.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

I. Lidhur me trajtimin e pabarabartë, të pretenduar nga ankuesi, për pezullimin nga detyra e përgjegjës të departamentit të shkencave politike dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, Komisioneri ka vërejtur se:

Ankuesi H.F prej vitit 2012 ushtron detyrën si Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale.

Me Vendimin nr.103, datë 21.07.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale pas konstatimeve të disa shkeljeve të akteve nënligjore në veprimtarinë e përgjegjës të departamentit është vendosur pezullimi i tij nga detyra e Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Politike, duke e lënë në detyrën si pedagog brenda departamentit.

Me Vendimin nr.163, datë 21.10.2014 të Rektorit të Universitetit të Tiranës, është vendosur zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës të pedagogut H.F, me motivacionin: "Për shkelje të përsëritura dhe të rënda të disiplinës në punë".

1. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në procesin e dorëzimit të procesverbalit të notave të provimit të studentëve dhe doktorantëve.

Komisioneri vlerëson se në nenet 49, 50 dhe 51 të Rregullores së Brendshme të Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendimin nr.5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të UT-s, parashikohet në mënyrë të detajuar procedura, afati dhe ankimi i rezultateve të provimeve. Kështu në nenin 49 është parashikuar se rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.

Bazuar në shkresën nr.117, datë 05.02.2014 të sekretarisë të Fakultetit të Shkencave Sociale drejtuar zv/Dekanit F.B, në të cilën shkuhet se procesverbali për lëndën "Metoda Kërkimore Sasiore" e cila zhvillohet nga Dekani, TH.K është dorëzuar në kohë dhe gjendet e arshivuar në

sekretari, vlerësohet se pretendimi i H.F për trajtim të pabarabartë në lidhje me këtë fakt nuk vërtetohet.

Referuar shkresës nr.197, datë 05.06.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale drejtorit të Departamentit të Shkencave Politike, në të cilën kërkohet informacion në lidhje me mosdorëzimin e procesverbalit të notave të provimit të lëndës “Filozofia e njeriut dhe politikës” të zhvilluar në datë 28.02.2014, vlerësohet se është e provuar mosrespektimi i afatit nga ana e H.F, sipas nenit 49 të rregullores së brendshme të UT-s.

Ndërkohë që referuar shkresës nr.385, datë 07.07.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale në të cilën i është kërkuar informacion, Departamentit të Shkencave Politike mbi mosdorëzimin e procesverbaleve të disa lëndëve mësimore dhe arsyet e mosdorëzimit të tyre, vlerësohet se në vazhdim të verifikimit të procedurave është konstatuar se tre pedagogë nuk kishin dorëzuar në kohë procesverbalet e provimeve dhe për ato nuk është marrë masë disiplinore.

Në nenin 30 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Brendshme të UT-s, përcaktohet se: 1. *“Masat disiplinore për të gjithë punonjësit e UT jepen nga Rektori, si rregull me propozim të dekanit/drejtorit të njësisë kryesore apo Koncelarit të UT”*, dhe 2. *“Përgjegjësi i departamentit dhe kancelari i njësisë kryesore, kanë gjithashtu të drejtë të propozojnë masa disiplinore për personelin akademik, ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ të njësisë që ata drejtojnë. Këto masa ata i propozojnë tek dekanit/drejtorit të njësisë kryesore dhe në rast mospërputhje, drejtpërdrejt tek Rektori”*.

Referuar për sa më sipër, vlerësohet se Dekani i Fakultetit, pasi ka konstatuar shkeljen e mosdorëzimit në kohë të procesverbaleve të provimeve nga ana e pedagogëve të tjerë, pavarësisht propozimit apo jo për dhënie mase disiplinore nga ana e përgjegjësit të departamentit mund të kishte propozuar masa disiplinore sipas parashikimeve të nenit 74⁹ të Statutit të UT.

2. *Lidhur me pretendimin se vetëm për H.F është kryer verifikimi i procedurës së prezencës në punë dhe udhëtimeve jashtë shtetit, ndërkohë që dhe përgjegjës të departamenteve dhe pedagogë të tjerë të fakultetit kanë udhëtuar jashtë shtetit dhe nuk janë kryer verifikime nga ana e drejtuesve të Universitetit.*

Në pikën 3 të shkresës nr.187, datë 09.11.2012 të Universitetit të Tiranës, përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat për leje vjetore nga stafi akademik do të bëhen me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit do të paraqesë një propozim me shkrim pranë Dekanit dhe leja do të konsiderohet e dhënë deri në një javë kur miratohet nga Dekani dhe për më shumë se një javë do të konsiderohet e dhënë kur të miratohet nga Rektori”*.

⁹ Llojet e masave disiplinore janë: Tërheqje vëmendje, vërejtje me shkrim, vërejtje me paralajmërim, pezullim nga detyra dhe largim nga puna.

Nga shqyrtimi i dokumenteve¹⁰ të vëna në dispozicion nga palët, vlerësohet se nga ana e Dekanit të Fakultetit në mënyrë të përsëritur i janë kërkuar sqarime H.F në lidhje me mosparaqitjen në punë në datat: 20.02.2014, 21.02.2014, 21.03.2014, 26.09.2014, 27.09.2014, 17.10.2014, 18.10.2014, 30.10.2014, por H.F nuk ka dhënë sqarime me shkrim po ashtu dhe nuk është paraqitur në takim për të informuar për mungesat.

Bazuar në vlerësimin e dokumenteve¹¹ të dorëzuara nga palët, arrihet në përfundimin se nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale i është kërkuar Rektoratit verifikimi i informacionit mbi mosparaqitjen në punë të z.Feraj gjatë periudhës së vitit 2013-2014, si dhe nga ana e këtij Fakulteti nuk është kërkuar informacion Rektoratit për pedagogë të tjerë, pasi lëvizjet e tyre janë bërë në bazë të procedurave të përcaktuara.

Bazuar në dokumentet e disponuara gjatë inspektimit të datës 27.05.2015 dhe shkresës nr.131, datë 09.02.2015, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore drejtuar Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Sociale¹², vërtetohet se në Fakultetin e Shkencave Sociale ka një praktikë të konsoliduar të procedurës të përdorur nga ana e pedagogëve për rastet e kërkesave për leje, siç është procedura e përdorur në rastin e kërkesës për leje të pedagoges së Departamentit të Shkencave Politike, M.Xh si dhe për vetë ankuesin në rastin e miratimit të lejes në datat 29.10.2013 dhe 21-24.05.2014.

Referuar për sa më sipër, vlerësohet se nuk kemi trajtim të pafavorshëm të subjektit ankues në lidhje me kërkesën për verifikimin e mosparaqitjes në punë nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale pasi H.F ka patur mundësinë që ti përgjigjej me shkrim apo drejtpërdrejtë Dekanit në lidhje me arsyet e mosparaqitjes në punë.

3. Lidhur me pretendimin se nga ana e Dekanit i është konsideruar shkelje pse të gjitha provimet e studentëve të doktoratës i ka lënë për në fund të vitit.

Referuar shkresës nr. 845/5, datë 24.06.2014 të Rektorit të UT-s drejtuar Fakultetit të Shkencave Sociale, vlerësohet se, Senati Akademik i UT-s me Vendimin nr.39, datë 22.01.2014 ka vendosur miratimin në parim të ndryshimeve në planin mësimor të programit të studimit të doktoraturës në “Shkenca Politike” për vitin akademik 2013-2014, me kushtin që nga ana e Fakultetit duhej të paraqitej personeli akademik për çdo lëndë mësimore dhe kualifikimi përkatës.

Referuar shkresës, “Kthim informacioni” nr.89, datë 11.07.2014 të Përgjegjës të Departamentit H.F drejtuar Dekanit të Fakultetit, vërtetohet se procesi mësimor në nivelin e studimeve doktrale të vitit shkollor 2013-2014 ka qenë i ndarë në dy semestra: Semestri i parë: 15 janar – 30 mars 2014 dhe semestri i dytë: 7 prill – 15 qershor 2014.

¹⁰ Referuar shkresës “Propozim për masë disiplinore” nr.723, datë 08.10.2014, të Dekanit të fakultetit të Shkencave Sociale drejtuar Rektorit të UT-s.

¹¹ Referuar procesverbalit të inspektimit, datë 27.05.2015.

¹² Lista e lejeve të miratuara të stafit akademik për periudhën 01.09.2013 deri më 21.10.2014.

Në nenin 33 të Rregullores së Brendshme të UT-s, përcaktohet se: “Studimet në UT zhvillohen me bazë vitin akademik..... Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 javë. Çdo javë ka 20-25 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë”, ndërsa në nenin 23 pika 1 dhe 3, përcaktohet se: Përgjegjësi i Departamentit 1. “Drejton punën për hartimin e kurrikulave për të gjitha ciklet e studimeve të lëndëve që mbulon departamenti, planeve mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre” dhe 3. “Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera”.

Referuar shkresës nr.196/1, datë 05.06.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, vlerësohet se Dekani i është drejtuar të gjitha departamenteve për të marrë masat për dhënien e provimeve për studentët e doktoraturës. Po ashtu dhe me shkresën nr.187/4, datë 30.05.2014, Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale i është drejtuar të gjitha departamenteve për tu informuar rreth ecurisë së zhvillimit të mësimin të kursit për doktorantët, pra evidentohet se Dekani nuk ka qenë selektiv në kërkesat për Departamentet për realizimin e planit mësimor për studentët e doktoraturës.

Në shqyrtim të dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi trajtim të pafavorshëm të Përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Politike në raport me drejtuesit e departamenteve të tjera, pasi kërkesa për zbatimin e rregullores së universitetit nga ana e dekanit është një detyrim ligjor për drejtimin e fakultetit.

4. Lidhur me pretendimin se H.F ka kërkuar të shtyhet zhvillimi i një lënde në doktoraturë, ndërkohë që Departamenti i Psikologjisë, me përgjegjës A.T, ka harruar të zhvillojë një lëndë (Filozofi moderne bashkëkohore) për një vit në nivelin master, ndërsa në nivelin doktoral ka harruar dy lëndë pa zhvilluar të kursit teorik për vitin akademik 2010.

Referua shkresës nr.90, datë 06.02.2015 të Përgjegjësit të Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë drejtuar Dekanit të Fakultetit, në të cilën informohet se mangësia për moszhvillimin e lëndës “Filozofi moderne bashkëkohore” në kohën e duhur ka ardhur si rezultat i moszhvillimit të lëndës nga një pedagog i Departamentit të Filozofisë. Gjithashtu referuar po kësaj shkrese, vërtetohet se pasi është vënë në dijeni të këtij fakti, Përgjegjësi i Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë ka marrë masat që mësimi të zhvillohej brenda vitit mësimor, ndërsa për zhvillimin e dy lëndëve të nivelit doktoral, departamenti ka marrë të gjitha masat për realizimin e procesit mësimor duke zhvilluar mësimet dhe pasdite.

Ndërsa në rastin e shkeljes së konstatuar për H.F nga ana e fakultetit për mosrealizimin në kohë të lëndës “Hartimi i argumentit në shkencat politike”, vlerësohet se H.F me shkresën nr.64/1, datë 05.06.2014 ka kërkuar nga dekani miratimin për shtyrjen për semestrin e ardhshëm të kësaj lënde me arsyetimin e ardhjes me vonesë të miratimit të zhvillimit të kësaj lënde nga H.F.

Përsa më sipër, Komisioneri vlerëson se nuk kemi në kushtet të barabarta krahasimore, pasi në rastin e zhvillimit të lëndës nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë zhvillimi i lëndës në kohë nuk varej drejtpërdrejtë nga shefi i departamentit A.T, ndërkohë që u morën masat për

zhvillimin e lëndës brenda vitit mësimor, ndërsa në rastin e zhvillimit të lëndës nga Departamenti i Shkencave Politike, zhvillimi i lëndës në kohë varej drejtpërdrejtë nga shefi i departamentit H.F, i cili ka kërkuar shtyrjen e zhvillimit të kësaj lënde në semestrin tjetër dhe është bërë shkak për moszhvillimin në kohë të kësaj lënde.

5. Lidhur me pretendimin se Dekani i Fakultetit e ka konsideruar shkelje dhënien e një leksioni nga ana e H.F për të zëvendësuar pedagogen M.K pa u miratuar nga Dekani, ndërkohë që nuk është konsideruar shkelje zhvillimi i procesit mësimor për pedagogët e jashtëm të Fakultetit të Shkencave Sociale të cilët për periudhën Shkurt - Prill 2014 kanë qenë të pa miratuar.

Në nenin 72 të Statutit të UT-s, përcaktohet se: “Senati Akademik duke u mbështetur në propozimet e njësive kryesore dhe në varësi të fondit financiar që ka në dispozicion, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të përkohshme”.

Në nenin 26 të Rregullores së Brendshme të UT-s, përcaktohet se: “Njësitë kryesore në fillim të çdo semestri, përcjellin për miratim në Senatin Akademik, listën emërore të personelit akademik me kontratë të përkohshme, brenda numrit të miratuar për këtë kategori punonjësish nga organet përkatëse. Departamenti në fillim të çdo semestri, propozon për miratim në këshillin e fakultetit/institutit listën emërore të personelit akademik të ftuar”.

Referuar pretendimeve të subjektit ankues dhe përgjigjes së Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale me shkresën nr. 105/2, datë 10.02.2015 në të cilën citohet se është konsideruar shkelje që H.F kishte zëvendësuar pedagogen M.K pa miratimin e dekanit, ndërsa ishin të justifikuar pedagogët e jashtëm të cilët ishin lejuar të zhvillonin mësim pasi nuk ishin miratuar deri në nivel dekanit, Komisioneri vlerëson se, Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale është në shkelje të parashikimeve ligjore të sipërcituara dhe se përbën trajtim të pafavorshëm të H.F.

6. Lidhur me pretendimin se i është konsideruar shkelje dhënia e dorëheqjes nga udhëheqja e diplomës së një studenti, ndërkohë nuk ka asnjë rast tjetër që të jetë konsideruar shkelje pse pedagogu jep dorëheqje si drejtues i një teme diplome.

Referuar shkresës nr.464, datë 07.07.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, drejtuar Rektorit të UT-s, vërtetohet se nga ana e Dekanit është propozuar dhënia e masës disiplinore “Largim nga puna” për pedagogun e jashtëm E.H në mes të tjerash dhe për shkeljen e konstatuar të braktisjes së udhëheqjes së temave me studentët.

Përsa më sipër, dhe në këtë rast nuk vërtetohet trajtimi i pafavorshëm i H.F nga ana e Dekanit, pasi dhe në një rast tjetër është konsideruar shkelje braktisja e studentëve nga udhëheqja e diplomave pavarësisht se nuk ka një rregullim ligjor të parashikuar për këtë rast.

II. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj tij nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹³ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit.

Ankuesi ka pretenduar se shkak për diskriminim dhe viktimizimin ndaj tij janë bërë artikujt e botuar në media¹⁴ dhe shkresat e drejtuara në organet e drejtësisë¹⁵ në të cilat ka denoncuar shkeljet që ka vërejtur gjatë zhvillimit të veprimtarisë mësimore dhe administrative në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

Referuar shkresave datë 23.12.2014 dhe 19.12.2014 të H.F, drejtuar Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi, H.F shpjegon se:

- Kallëzimin penal të bërë në polici në datë 25.05.2014 kundër Dekanit e ka bërë në cilësinë si dëshmitar i kanosjes dhe presionit ndaj Përgjegjëses së Departamentit të Filozofisë, M.M për falsifikim dokumentesh.
- Kallëzimin ndaj Rektorit me datë 13.06.2014 e ka bërë, duke dëshmuar fakte e rrethana që e implikojnë rektorin në shpërdorim detyre dhe akte korruptive.
- Qëndrimet dhe artikujt në media kundër Rektorit dhe Dekanit kishin të bënin me mënyrën e administrimit të Universitetit ashtu dhe për konceptimin e tij si pasuri publike përkundër përdorimit privat të Universitetit.

Në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 3/8, përcaktohet se: “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë”.

Bazuar në dokumentacionin e sipërcituar, Komisioneri vlerëson se të gjitha kallëzimet dhe artikujt e bërë nga H.F kundër Rektorit të UT-s dhe Dekanit kanë të bëjnë me akuzat e tij lidhur me shpërdorimin e detyrës, aktet korruptive dhe mënyrën e administrimit të universitetit dhe nuk kanë qenë denoncime të një procedimi që ka synuar zbatimin e parimit të barazisë, dhe si rrjedhim nuk përbëjnë shkak për diskriminim.

Pra, siç shihet qartë, subjekti ankues nuk ka një shkak të përligjur nga ligji 10221/2010 mbi të cilin të ngrejë pretendimet e tija për trajtim të ndryshëm, të disfavorshëm apo diskriminues nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale në raport me H.F.

¹³ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹⁴ Artikulli i botuar në gazetën Panorama, datë 09.09.2014

¹⁵ Procesverbal Komisionariati Policisë Nr. 2, Tiranë, datë 26.05.2014, Ankesë drejtuar Rektorit të UT-s datë 30.05.2014, Kallëzim penal për shpërdorim detyre nr.3785, datë 13.06.2014 dhe Kallëzim për ndjekje penale nr.2784 datë 17.09.2014.

Komisioneri gjykon, se Fakulteti i Shkencave Sociale solli pranë KMD-së argumente, prova dhe fakte konkrete, që të vërtetonin se trajtimi i ankuesit ishte objektiv, i arsyetuar dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat, që duhet të ndiqen për funksionimin e Fakultetit të Shkencave Sociale.

Nga parashtrimi i fakteve dhe shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se, nuk ka veprime apo mos veprime nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale në dëm të ankuesit, që të ketë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, në raport me drejtuesit e departamenteve të tjera. Pra, qëndrimi i Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale me përjashtim të trajtimit sipas pikës II/5 ka qenë në përputhje me parashikimet ligjore dhe të rregullave dhe jodiskriminues, i mbështetur në argumenta të arsyeshme dhe objektive.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i ankuesit në raport me drejtuesit e departamenteve apo pedagogët e tjerë nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, pasi nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Për sa më sipër, nuk rezulton të kemi shkelje të nenit 3, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili përcakton se: *““Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit H.F, nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale Th.K, për shkak të artikujve të botuar në media dhe kallëzimeve të bëra në organet e drejtësisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: artikuj denoncues te botuar ne media)
(fusha: punesim)